

Rexhep Qosja

SEMIOTIKA E MONUMENTEVE

Poezia e një mbishkrimi

Provën e parë iluministe dhe, njëkohësisht, poetike romantike Thimi Mitko do ta bëjë herët, në moshën 23 vjeçare, në vitin 1843, kur në pllakën e shkollës teksa të rindërtuar të Korçës do të shënojnë këto fjalë: „I ndriçim Djell i diturisë lindi, zë vjen mbi të gjithë, ngrehu e shiko o nën'e dashur, shekullin e dritës o plaka jime. Degë, fëmijë, kini dëshirë në dituri, atyre t'u ngjisni, na mësonjëtoje u ngrehmë dhuratat e Musavet të fitoni”.¹ Nuk ka dyshim se ky tekst poetik, i përshkuar prej një patosi të përmbajtur iluminist, shënjon disponimin arsimor dhe kulturor jo vetëm të korçarëve, por edhe të atyre shqiptarëve të tjerë në atë kohë, që kishin filluar të kuptojnë, me një vetëdije të re, rëndësinë e „dritës së diturisë” në gjuhën kombëtare. Pavarësisht prej elegancës së tij gjuhësore, që më tepër të përkujton stilin e huaj klasikist sesa stilin romantik, që zotëronte në shkrimin e asaj kohe në Evropë, teksti i këtij mbishkrimi e shënjon qartë dhe konkretisht vetëdijen e re që ishte realizuar në aktivitetin iluminist dhe letrar të Naum Veqilharxhit, por që ata, korçarët dhe shqiptarët e tjerë, do ta njohin dy-tre vjet më vonë.

Mbasi të kuptojë se përveç diturisë, që mësohet prej librave është edhe një dituri tjetër, që mësohet prej jetës, dhe mbasi të bëjë edhe një sërë provash të tjera iluministe, letrare dhe letrare-shken-core, Thimi Mitko do të ketë mundësi të bindet se „diell i diturisë” as nuk lindet, as nuk „ze vjen mbi të gjithë” ashtu lehtë siç e pandehte në fillime, kur e kishte skalitur mbishkrimin e shollës së Korçës. Disa vjet më vonë, mbasi të ketë kuptuar qëllimin dhe rëndësinë e Lëvizjes së Rilidjes Kombëtare, gjendjen e popullit të tij dhe realitetin politik evropian, ai do të bindet se, sikundër ishte bindur edhe Naum Veqilharxhi përpara, arsimi dhe dituria në gjuhën kombëtare ishin faktorët themelorë të emancipimit kulturor dhe kombëtar të shqiptarëve. Po, në ato kushte, ai do të kuptojë shpejt se ky „diell i diturisë”, që do të duhej të ndriçonte shqiptarët, do të

¹ N (u ç i) D. N (a ç i), *Korça edhe katundet e qarkut*. E stypur për së dyjti me ndryshime të mjafta. Dhori Koti, Korçë 1923, f. 12.

ketë edhe heronj, edhe viktimë, sepse do të ketë edhe kundërshtarë. Jo rastësisht, prandaj, ai do t'i nxisë bashkëvendësit e tij, me vargje, që të shkruajnë gjuhën e tyre:

*Shkruani gluhën'e këndonit,
mbsohuni seç është' njerzia,
djelmtë në shkollë dërgoni,
ashtu urdhëron perëndia.²*

por edhe do t'ua përkujtojë viktimën e parë të alfabetimit të kësaj gjuhe në periudhën romantike — Naum Veqilharxhin:

*E kur Veqilharxhi gjorë
nxorri shkronjzat nga Vllahia,
befas vdiq Stamboll pa gojë
e si vdiq e di perndia.³*

Bukuria iluministe dhe njëkohësisht, poetike romantike e mbi-shkrimit në pllakën e shkollës së Korçës nuk do të cilësojë edhe jetën praktike të autorit të saj. Thimi Mitko do të kalojë një jetë, vërtet, prozaike, por një jetë prozaike të cilën do ta kuptimësojë me idetë dhe me vizionet romantike, që e shquajnë Rilindjen Kombëtare. Bir tregtari, ai do të kalojë tërë jetën duke u marrë me tregti. Shkollën fillore, në gjuhën greke do ta kryejë në qytetin e lindjes, në Korçë. Me ndryshim prej numrit më të madh të romantikëve tanë, të cilët mbas shkollimit në ndonjërin prej gjuhëve të huaja — në greqishte, në turqishte ose në italishte — i vazhdojnë mësimet në vende të huaja, si në Greqi, në Itali, në Rumani ose në ndonjë vend tjetër, Thimi Mitko nuk do të shkollohet më tutje. Po, në vend të shkollës së rregullt dhe të dijeve që sjell ajo, ai do të kujdeset të kryejë një shkollë tjetër dhe të marrë aso dije të shtrenjtë, që shpesh, nuk e sjell shkolla e rregullt: do të kujdeset të kryejë shkollën e vështirë të jetës.

Punët e tregtisë, së paku për disa vjet me radhë, do ta bëjnë Thimi Mitkon një endacak të vërtetë. Në cilësinë e tregtarit do të mbërrijë ai në disa vende dhe në një varg qytetesh, ku do të ndalet më gjatë ose më shkurt. Për punë tregtie do të mbërrijë në Manastir, në Shkodër, në Selanik, në Athinë, në Stamboll, në Bukuresht, në Kairo, në Aleksandri, në Trieshtë, në Venedik, në Vjenë duke kaluar edhe nëpër sa vende e qytete të tjera.⁴ Punët e tregtisë do ta vonojnë në aktivitetet me të cilat do të merret më vonë, por punët e

² Thimi Mitko, *Vepra*, Akademia e Shkencave e RPSSH. Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë 1981, f. 588.

³ *Aty*, f. 602.

⁴ Qemal Haxhihasani: *Hyrje e Veprave të Thimi Mitkos* f. 15.

tregtisë edhe do t'i bëjnë të mundshme të shohe se janë disa punë të tjera shumë më të rëndësishme se tregtia. Duke u marrë me tregtinë do të njohë njerëz të dryshëm, të kërsërive, të prirjeve, të bindjeve dhe të moraleve të dryshme: njerëz të politikës, të arsimit, të shkencës dhe artit. Prej këtyre udhëtimeve, dhe prej këtyre takimeve ai do të mësojë shumë. Sikundër do ta dëshmojë puna e tij e mëvonshme, prej këtyre udhëtimeve dhe prej këtyre takimeve, ai do të mësojë se në kohën në të cilën jetonte ai dhe në kushtet në të cilat gjendej vendi i tij, puna e tij tregtare do të ketë kuptim dhe rëndësi, në qoftë se do t'u shërbejë disa qëllimeve më të larta dhe më të përgjithshme se ç'është pasuria. Është plotësisht e kuptueshme, prandaj, pse dikur ai do të merret me tregtinë, në radhë të parë, që të mund të ushtrojë më me sukses ndikim në një fushë tjetër — në fushën e arsimit dhe të emancipimit kombëtar; do të merret me tregtinë, në radhë të parë, që të mund t'i përhapë më me sukses idetë e mëdha të Rilindjes Kombëtare. Sado për qëllime tregtare, dalja e tij në botë, udhëtimet nëpër vende dhe qytete të ndryshme, të Lindjes dhe të Perëndimit, takimet me njerëz të dijeve, të profesioneve dhe të bindjeve të ndryshme do ta bëjnë që ai, mandej, të mund të merret me disa aktivitete të tjera dhe të luajë rol të çmuar në jetën letrare dhe kulturore të Kombit. Në këtë mënyrë, shkolla e shtrenjtë e jetës do të bëjë prej një tregtari të thjeshtë, një shembulltyrë të çmuar të letërsisë romantike shqipe.

Në saje të përvojës së fituar në jetë, të urtësisë së lindur dhe të vetëbindjes për vlerën personale, ai do të mund t'i lejojë vetes një sërë iniciativash që nuk mund t'ia lejonin vetes të gjithë romantikët — e aq më pak tregtarët — domethënë një sërë idesh, përpjekjesh, të bërash kulturore që mund t'ia lejojnë vetes vetëm ata individë, të cilët iu kanë kushtuar plotësisht aktivitetit intelektual. Kështu, për shembull, ai do të mund t'i lejojë vetes që të polemizojë me shkencëtarë a gazetarë të huaj për çështje historike, kulturore dhe politike: që të letërkëmbehet ose të bashkëpunojë me autoritete të shkencës a të letërsisë, sikundër ishin Jeronim de Rada, Dhimitër Kamarda, Dora d'Istria Anastas Kullurioti, Gustav Majeri, Zef Skiroi, Jan Urban Jarniku e të tjerë;⁵ që të nxisë romantikët arbëreshë për nxjerrjen e një gazete në gjuhën shqipe; që të hulumtojë, pak a shumë, traditën historike dhe kulturore kombëtare; që të merret me shpjegime fjalësh, emrash, monumentesh kulturore, që, gjithsesi, i tejkalojnë aftësitë e tij profesionale; të të propagandojë pastërtinë e gjuhës shqipe dhe afrimin e dialekteve të saj; që të shkruajë vjersha patriotike; që të shkruajë, madje edhe *Marsejezën* shqiptare; që, kohë pas kohe, të vihet në rolin e *movensit* shpirtëror të jetës kulturore gjatë Rilindjes kombëtare.

Mësimet që do të marrë në shkollën e jetës mençuria dhe vetëbesimi, do t'i bëjnë të mundshme Thimi Mitkos, ndërkaq, që të

⁵ Qemal Haxhihasani, *Thimi Mitko*, Naim Frashëri, Tiranë 1962, f. 5.

realizojë edhe një përpjekje për atë kohë posaçërisht të rëndësishme të kulturës shqiptare, që përjashta, në botën e huaj, ishte vështirë të realizohej: që të mbledhë dhe të botojë thesarin shpirtëror të popullit. Gjatë shekullit XIX, në botën e jashtme janë shkruar veprat, pothuaj, më të rëndësishme të letërsisë, të shkencës dhe, në përgjithësi, të kulturës në gjuhën shqipe. Në botën e jashtme janë shkruar dhe janë botuar poemat e Jeronim de Radës, *Këngë të Milosaos bir i despotit të Shkodrës*, *Këngë të Serafina Topisë princeshë e Zadrimës* dhe *Skanderbeku i pafan*; veprat më të mira të Naim Frashërit *Lulet'e Verësë* dhe *Istori e Skenderbeut*; *Fjalori shqip-greqisht* i Konstandin Kristoforidhit; monografia historike publicistike e Sami Frashërit *Shqipëria ç'ka qenë ç'është e ç'do të bëhet?*, e të tjera. Po, në botën e huaj të mblidhet thesari shpirtëror i një populli — kjo është punë që nuk mund të bëhet lehtë dhe kjo është punë që mund ta bëjë pakkush. Dhe, pikërisht këtë punë që nuk bëhet lehtë dhe që nuk bëhet në botën e huaj; këtë punë, që është e natyrshme të bëhet në vendin ku ai thesar krijohet, e bën plotësisht të mundshme dhe e realizon me një sukses, vërtet, të rrallë nxënësi i dalluar i shkollës së jetës — Thimi Mitko.

Dhe, pikërisht me thesarin shpirtëror të popullit, të përmbledhur në vëllimin *Bëleta Shqypëtare*, të botuar nëpër revista dhe gazeta të ndryshme të kohës ose të lënë në dorëshkrim, Thimi Mitko do të bëhet një autor i merituar i romantizmit shqiptar. Në saje të rëndësisë artistike dhe të ndikimit që ky thesar i gjuhës shqipe do të ushtrojë në letërsinë dhe në jetën kulturore kombëtare gjatë shekullit të kaluar, bëhen më të rëndësishëm në pikëpamje historike letrare se ç'do të ishin pa të, jo vetëm esetë, gjithsesi të çmuara, po edhe vjershat dhe letrat që ai ka shkruar.

Krijimtaria letrare e Thimi Mitkos dëshmon, kështu, se ai ishte kujdesuar që më së pari vetë, gjatë jetës, t'u përmbahet me kujdes porosive që u kishte dhënë të tjerëve në mbishkrimin e shkollës së Korçës. Për këtë arsye edhe mund të thuhet: në qoftë se teksti i gdhendur në pllakën e shkollës së Korçës, në njërin anë shenjon kërrshërinë e re iluministe kulturore të shqiptarëve të asaj kohe, në përgjithësi, në anën tjetër, simbolizon ardhmërinë e autorit të saj, Thimi Mitkos, në kulturën shqiptare.

Proza historike letrare

Mbas shënimit që do të gdhendë në pllakën e shkollës së rindërtuar të Korçës do të kalojnë afër pesëmbëdhjetë-gjashtëmbëdhjetë vjet derisa Thimi Mitko të marrë, rishtazi, iniciativën që të shkruajë. Gjatë këtyre vjetëve emri i tij do të shënohet, kryesisht, nëpër regjistrat e tregtisë në Korçë, në Manastir a në qytete të tjera, ku do ta sjellin punët tregtare. Në vitin 1859, emri i tij, papritmas, do të gjendet në faqet e gazetës Pandora në gjuhën greke, që botohej në Athinë. Prej këtij viti e deri në fund të jetës, Thimi Mitko

do të shkruajë një numër të kufizuar esesh dhe artikujsh, ndër të cilët dallohen *Disa shënime rreth Korçës*, *Gazeta e Livornos sjell mbi çështjen shqiptare sa vijojnë*, *Nyl për flamburin*, *Topografia e Korçës*, e të tjera. Në këto proza ai trajton çështje aktuale me karakter historik politik, etnografik, antropogjeografik dhe historiko-artistik, duke themeluar, njëkohësisht, një zhanr të veçantë të prozës publicistike të romantizmit shqiptar: prozën historike letrare.

Prej të gjitha prozave të Thimi Mitkos interes të veçantë kanë prozat *Disa shënime rreth Kroçës*, i botuar në vazhdime, me ndërprerje të mëdha, gjatë disa vjetësh, në gazetën e Athinës, *Pandora* dhe *Topografia e Korçës*, i botuar në revistën e Jeronim de Radës *Fiamuri Arbërit*, në vitin 1884. Me këto dy proza Thimi Mitko bën portretin antropogjeografik, historik politik dhe historik kulturor të Korçës, ashtu siç ishte dhe ashtu siç nuk kishin mundë ta shohin ata autorë të huaj, që për të kishin shkruar me motive thjesht politike.

Prej përmbajtjes së prozës *Disa shënime rreth Korçës* mund të shihet fare qartë se, në kohën kur nis ta shkruajë, Thimi Mitko është autor me pikëpamje plotësisht të formuara historike, politike dhe kulturore, sepse është autor me vetëdije plotësisht të formuar kombëtare.

Dhe pse të mos ketë në atë kohë vetëdije të formuar kombëtare?

Gjatë ecejakeve të tij tregtare nëpër Ballkan dhe nëpër Evropë kishte parë dhe kishte dëgjuar shumëçka, prandaj edhe ishte kujdesur që të përmbushte sa më mirë porosinë që u kishte dhënë të tjerëve me tekstin e pllakës përkujtimore të shkollës së rindërtuar të Korçës: „kini dëshirë në dituri”. Konteksti politik dhe intelektual i vendit e kishte ndihmuar që t'i kuptonte drejt dhe t'i sqaronte plotësisht vrojtimet e veta në Ballkan dhe në Evropë. Në të vërtetë, Shqipëria, Ballkani dhe Evropa ishin shpjeguar reciprokisht në vetëdijen e tij, në atë kohë.

Kjo është kohë kur Lëvizja e Rilindjes kombëtare po zgjerohej gjithnjë e më dukshëm, kur po shtohej numri i pjesëmarrësve të saj të shkolluar, kur nuk ishte më vetëm lëvizje iluministe, por edhe lëvizje politike historike. Kjo është kohë kur studimet historike, gjuhësore, folkloristike dhe etnografike mbi shqiptarët janë gjithnjë e më të shpeshta: kur shkrimet e studiuesve dhe të poetëve, si të Gjuzepë Krispit — mbi origjinën e shqipes, të Vinçenc Dorsës — mbi traditat kulturore dhe zakonet shqiptare; të Jeronim de Radës — mbi origjinën pelazgjike të shqiptarëve; të Dhimitër Kamardës — mbi gjuhën, folklorin dhe letërsinë shqipe kanë filluar gjithnjë e më dukshëm të tërheqin interesimin jo vetëm të qarqeve intelektuale, por edhe të qarqeve politike evropiane. Dhe ky interesim do të shtohet posaçërisht shumë në vitet para Kongresit të Berlinit, kur çështja ballkanike ishte bërë një prej çështjeve të para të diplomacisë evropiane. Evropa e kësaj kohe, e tronditur prej luftërave të pandërprera, por e zgjuar prej gjumit të gjatë feudal; Evropa e revolucioneve

dhe e kundërrevolucioneve të shpeshta, e idealeve demokratike republikane dhe e ngarkesave shekullore rojaliste; Evropa e romantizmit, që ende nuk ishte shuar dhe e realizmit, që shquhej gjithnjë e më fort, bëhej dëshmitare e lindjes së një shkence të re — e lindjes së shkencës albanologjike, si shenjë e një identitetit kombëtar të një populli — të Popullit shqiptar — që ajo vetëm rrallë e tek e kishte kujtuar që prej çerekut të fundit të shekullit XV, kur ishte katandisur nën sundimin e Perandorisë Otomane. Po lindjes dhe rritës së kësaj shkence i kishin kontribuar dhe do t'i kontribuojnë edhe një varg studiuesish evropianë në mesin e të cilëve shquajnë autorët siç janë Franc Bop, Johan Georg Han, Reinhold, Gustav Majer, e të tjerë.

Dhe, kësaj shkence të re, zgjerimit, thellimit dhe pasurimit të saj, do t'i kontribuojë edhe Thimi Mitko dhe do t'i kontribuojë, jo vetëm me mbledhjen e thesarit shpirtëror të popullit, po, pakashumë, edhe me prozën e tij historike letrare.

Semiotika e monumenteve

Prozat e Thimi Mitkos, *Disa shënime rreth Korçës dhe Topografi e Korçës* si me karakterin e të dhënave, ashtu edhe me semantikën e tyre, hyjnë ndër prozat me interesante të romantizmit shqiptar.

Pse mund të thuhet kështu?

Në vija të përgjithshme, në to flitet për pozitën gjeografike të qytetit të Korçës, për kushtet klimatike, për popullsinë dhe besimet e saj, për bujqësinë dhe, në përgjithësi, për ekonominë, për zejet më të zhvilluara dhe më interesante, për tregtinë dhe pazarin, për kushtet natyrore të komunikimit me fshatqytetet dhe fshatrat përreth, për shkollat dhe gjuhët në të cilat mësohet në to. Të gjitha këto të dhëna, ndërkaq, zënë një hapësirë të kufizuar në prozën rreth Korçës dhe zënë një hapësirë, ashtu, të kufizuar, për arsye se ajo, para së gjithash, është shkruar me një qëllim tjetër: me qëllim që të jepen të dhëna historike kulturore. Në qoftë se krahasohet hapësira që Thimi Mitko u jep të dhënave gjeografike në krahasim me hapësirën që u jep të dhënave, para së gjithash, historike kulturore, do të shihet fare qartë se ai edhe nuk është i interesuar të shkruajë Topografinë e Korçës; ai, në të vërtetë, është i interesuar të shkruajë historinë kulturore të Korçës. Pavarësisht pse janë relativisht të shkurtra dhe pavarësisht pse fondi i të dhënave të tyre është, relativisht, i varfër, prozat e Thimi Mitkos *Disa shënime rreth Korçës dhe Topografi e Korçës* përbëjnë portretin më të bukur kulturor që për ndonjë qytet shqiptar është shkruar gjatë shekullit nëntëmbëdhjetë.

Si edhe romantikët e tjerë shqiptarë, ashtu edhe Thimi Mitkon, kryesisht, e preokupojnë vizionet historike të popullit, të vendit, prandaj edhe të qytetit ku ka lindur. Pavarësisht se cila do të jetë

tema e trajtimit të tij, edhe ai, doemos, ndien nevojë të merret me historinë e saj. Në të gjitha anët ai, e sheh historinë dhe prej të gjitha anëve ai kujdeset të mbledh të dhëna me të cilat do të mund të krijojë, vizione, historike. Duke iu përmbajtur një prozedeu të tillë në prozën e tij, është e kuptueshme pse Thimi Mitko bëhet njëri prej romantikëve të parë që e ndihmon formimin e historizmit romantik dhe e ndihmon pikërisht me prozat e tij mbi Korçën dhe rrethinën e saj.

Në prozat *Disa shënime rreth Korçës dhe Topografi e Korçës* vizionet historike të Thimi Mitkos krijohen mbi të dhëna që nuk janë shfrytëzuar përpara tij dhe në letërsinë e romantizmit shqiptar nuk do të shfrytëzohen, pothuaj, as mbas tij.

Cilat janë këto të dhëna?

Duke u përpjekur të shkruajë historinë e Korçës, dhe të rrethinës, Thimi Mitko, praktikisht, shkruan historinë e kulturës së saj materiale. Dëshmi të kësaj kulture për të, pikësëpari, janë rrenojat, kështjellat, kishat, manastiret dhe kodikët e tyre. Nuk mbetet asnjë rrenoje, asnjë kështjellë, asnjë kishë, manastir a kodik që nuk i shënon në prozat e tij mbi Korçën, në të vërtetë, që nuk i përshkruan me një gjuhë e cila, në shikim të parë, duket racionale, e ftohtë, por e cila, doemos, shpreh qëndrimin e tij emocional ndaj historisë. Në qoftë se historinë e themelimit të Korçës e mbështet në legjendën mbi Koxha Mirahorin, historinë e zhvillimit të saj do ta mbështesë në të dhënat materiale që dëshmojnë traditat e saj kulturore. Prandaj është plotësisht e kuptueshme pse interesimin e tij e tërheqin rrethoja e një fshati të shkatërruar, që quhet Athanasica, xhamia dhe hamami i Mborjes, kodiku i Mitropolisë së shenjtë të Korçës, kodiku i Manastirit të Shënprodhomit në Voskopojë, manastiri i Shënkollit në Kamenicë, manastiri i apostujve Pjetër e Pavel në Vitkuq, manastiri i Shëndëllisë në Koçish, kështjella qytet e Drenovës, tempulli i vogël i Shën Konstandinit në malin e Drenovës, manastiret e Shënkollit e të Shënmërisë në Boboshticës, themelet e një muri të lashtë e të gjatë, që e pandeh mur kështjelle në Boboshticë, pranë Manastirit të Shënkollit, rrenojat e dy kullave mbi dy maja mali të Boboshtica, Kisha e Shëngjergjit në Magulen e afërme e të tjera, e të tjera. Topografia e Korçës bëhet, kështu, topografi e monumenteve më të bukura të kulturës së saj materiale. Mirëpo, Thimi Mitko nuk do të kënaqet vetëm që t'i regjistrojë këto monumente: në disa raste, ai do të shikojë përjashta tyre ose do të futet edhe brenda tyre dhe do të vërejë në mos gjen edhe dëshmi të tjera historike kulturore. Kështu, fjala vjen, brenda vrojttimeve të tij mbi semiotikën e monumenteve do të përmenden, kur e kur, edhe monedhat e zbuluara. Kujdes të veçantë, ndërkaq, do t'u kushtojë kodikëve, të cilët do t'i regjistrojë dhe, në disa raste, do t'i lexojë. Prej tyre do të nxjerrë shënime se kur mund të jetë ndërtuar monumenti, të cilit ai kodik i takon, se cili klerik në cilën kohë mund të ketë shërbyer aty, se cilat ishin lidhjet e atij monumenti me monumentet e tjera, cilat ishin hierarkitë, cilët ishin bëmirësit e tij. Kodikët

bëhen, ashtu, histori e shkurtër e monumenteve dhe, madje, e qytetit e klerikëve që kanë shërbyer në ta, e bëmirsëve të tyre, e lidhjeve, ndërmjet njerëzve, mitropolive dhe krahinave. Në këtë mënyrë rrenojat e mureve të lashta, kështjellat, monumentet e kultit religjioz dhe kodikët e tyre bëhen shenja që e plotësojnë hapësirën historike, ashtu sikundër bëhet pllaka me mbishkrim në shkollën e rindërtuar të qytetit të Korçës shenjë që e plotëson hapësirën shoqërore të vetëdijes kulturore dhe kombëtare të borgjezisë së qytetit. Ato e shënojnë një traditë, një kulturë, një ekzistencë që nuk mund të shlyhet në asnjë mënyrë. Edhe në qoftë se forma e monumentit mund të rrënohet, forca shënjuese e rrënojave të tij është e pazhdukshme. Nuk janë monumentet e kulturës materiale të vetmet shenja, në bazë të cilave Thimi Mitko ndërton historinë e Korçës, respektivisht të Shqipërisë. Dinjitet që të dhënave materiale ai iu jep, me të drejtë edhe të dhënave shpirtërore me të cilat ndërton vizionet historike kombëtare. Qëllimeve të tij historike kombëtare posaçërisht do t'u shërbejnë edhe një sërë fjalësh që, në po këto proza, i shenjon si fjalë të lashta greko-shqiptare, që mund të shpjegohen vetëm me gjuhën shqipe. Në këtë mënyrë edhe fjalët, porsì rrënojat, porsì kështjellat, porsì kishat dhe manastiret, porsì kodikët e tyre, bëhen shenja të një ekzistence të lashtë: shenja të një kulture, të një vetëdijeje shumë më parë se shenja të një besimi. Shenja të një lashtësie, fjalët bëhen, ashtu, shenja të individualitetit kulturor kombëtar.

Pse Thimi Mitko e shndërron topografinë e Korçës në histori të monumenteve të kulturës së saj?

Duke shkruar topografinë e Korçës dhe të rrethinës së saj, Thimi Mitko e përqendron vëmendjen e tij në monumentet kulturore, në radhë të parë, për arsye se ka një qëllim të caktuar: për arsye se ka për qëllim që të dëshmojë se populli shqiptar është një popull i lashtë, një popull i lashtë me një kulturë të lashtë.

Me semiotikën e monumenteve kulturore, Thimi Mitko, praktikisht, u qëndron ndesh atyre shkrimeve, në të cilat, duke u mohuar gjuha shqipe, kultura shqiptare, lashtësia e popullit shqiptar, praktikisht, synohej mohimi i individualitetit kombëtar të këtij populli. Proza historike letrare e Thimi Mitkos, në të cilën përmes përshkrimit të monumenteve kulturore, në njërin anë kurse të disa fjalëve, në anën tjetër, zbulohet shenjësimi dhe simbolizmi i tyre, objektivist, ishte përgjigjja më efikase kundër propagandizmit të atyre shkrimeve.

Ngarkesën shënjuese dhe simbolike të monumenteve që regjistron, Thimi Mitko sikur e shquan, ndërkaq, edhe me gjuhën e tij. Sado në shikim të parë racionale, gjuha me të cilën ai përshkruan monumentet dhe regjistron përmbajtjen e kodikëve të disave prej tyre, është gjuhë e traditës edhe me strukturën e saj narrative; lashtësia e monumenteve në prozën e tij theksohet ashtu edhe me lashtësinë e formës së diskursit për ta, që, më parë se diskurs publicistik, është thënie e prozës artistike. Në saje të formës së kallë-

zimit, të dhënat e planit gjeografik, historik dhe kulturor sikur marrin karakter të të dhënave poetike, me ç'rast nuk çënohet vërtetësia e tyre. Pa patosin dhe retorikën e prozës publicistike të romantizmit, sidomos mbas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por edhe pa patosin e vargjeve të tij, proza e Thimi Mitkos mbi topografinë e Korçës të kujton traditat e njohura të romanit historik evropian, të cilat ai edhe mund të mos i ketë njohur: „Pranë manastirit të Shënkollit, në bregun e majtë të lumit që rrjedh atje pranë gjenden themelet e një muri të vjetër dhe të gjatë rrethues, ndoshta të ndonjë kësh-tjelle, në një pozicion më të lartë në krahasim me fshatin. Aty dallohen edhe dy porta të mëdha, njëra nga lindja, afër luginës së maleve, dhe tjetra nga perëndimi, pranë fshatit të tanishëm”.⁶ Në këtë mënyrë poezia e paraqitjes së monumenteve kulturore shqiptare vetvetiu bëhet poezi e semiotikës së tyre historike.

Vjershat

Jo vetëm me vlerën shenjuese kulturore, por as me vlerën thjesht poetike të prozës historike publicistike të Thimi Mitkos nuk do të shquhen edhe vargjet e tij. Thimi Mitko nuk ka shkruar shumë vjersha; dhe, me përjashtim, të vjershës *Mbë Shqypëtarët*, nuk ka shkruar as vjersha të gjata. Vjershat e tij, në pjesën më të madhe të rasteve, janë botuar në gazeta, disa në përmbledhjet e për-bashkëta, që kohëpaskohe nxirrnin romantikët tanë, kurse një numër i tyre ka mbetur në dorëshkrim. Ndonjëherë ai e lëshon në qarkullim vjershën si afishe, ua dërgon miqve dhe të njohurve duke e dëshmuar, kështu, qëndrimin e tij ndaj poezisë përgjithësisht. Prej vjershave të tij, përgjithësisht, mund të shihet fare qartë se motivet me të cilat Thimi Mitko shkruan vargje, kryesisht, nuk janë motive të poetit. Edhe prej përmbajtjes, edhe prej afishimit të ndonjë-rës prej vjershave të tij del se ai ka qëndrim fare utilitar ndaj poezisë. Poezia, për të, është një mjet i propagandës, natyrisht, i propagandës kombëtare. Prandaj është e kuptueshme, pse një numër të vjershave — sigurisht më tepër se asnjëri prej shkrintarëve të tjerë të romantizmit shqiptar — ua kushton disa individëve që janë bërë të njohur në saje të pasurisë, disa individëve që janë bërë të njohur në saje të gjeniut të tyre dhe disa individëve që janë bërë të njohur në saje të trimërisë së tyre. Kështu, për shembull, vjershat të fortëndriçmesë zonjës *Dorë Istriadë* dhe *Ende këtë vetë zonnjë*, ia kushton Elena Gjikes për kontributin e saj që u kishte dhënë dhe vazhdonte t'u jepte përpjekjeve për njohjen e traditave historike dhe kulturore të popullit shqiptar në Evropë; dy vjersha, vjershat *Jovan M. Bankës* dhe *Nxitje mbë Shqypëtarët*, ua kushton dy tregtarëve të pasur, Jovan Bankës dhe Anastas Avramidhit, të cilët kishin premtuar se pasurinë e tyre do ta lënë, me testament, për lë-

⁶ Thimi Mitko, *Vepra*, f. 553.

vizjen e rilindjes kombëtare; vjershën, *O Vasil Ruso Korçari*, ia kushton autorit të një abetari shqip, që ishte botuar në Bukuresht; ndër dorëshkrimet e tij janë gjetur edhe vjershat mbi Mehmet Aliun, themeluesin e Egjiptit, mbi Napoleon Bonapartën dhe mbi dy kapedanë shqipëtarë — pjesëmarrës në kryengritjen e Kretës, mbi Miço Kranidhiotin dhe Gaço Sulin.⁷ Vjershën *Korç'moj Korç'e mjera Korçë*, siç i thotë edhe titulli, Thimi Mitko do t'ia kushtojë vendindjes së tij, Korçës. Vjershën-kushtim më të bukur, ndërkaq, *Burri klan gruan e tij q'i vdiqi*, Thimi Mitko e shkruan me rastin e vdekjes së të shoqes. Me gjithë ngarkesën, vërtet, të fortë emocionale, edhe kjo vjershë dëshmon se prirja poetike e Thimi Mitkos, gjithsesi, është modeste në krahasim me rëndësinë që i kushton asaj. Poezinë ai nuk e çmon për shkak të vlerë së saj si art, sa e çmon për shkak të gjuhës dhe të jetës popullore që e dëshmon. Në letrën që i dërgon Jeronim de Radës në vitin 1888, përpos të tjerash, ai shkruan: „Zotëria jote bën mirë të do të zësh prapë bejtarinë, se atje është vistari i gjuhës, duket' edhe jeta e shqypëtarit”.⁸

Më parë se artistike gjuhësore, vjershat e Thimi Mitkos kanë rëndësi historike letrare. Njëpërmjet tyre, përpos evolucionit krijues të autorit, në njëfarë mase mund të përcillet edhe evolucioni metriko ritmik i vargut shqip përgjithësisht gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX.

Sikundër mund të shihet prej vjershave *Të fortëndriçmesë zonzës Dorë Istriadë* të shkruar në Kairo në vitin 1869 dhe të botuar në vëllimin e përbashkët e përgatitur prej Dhimitër Kamardës *Dora d'Istrias — Shqipëtarët*, dhe prej vjershës *E ndë shqypëtarëtë gjithë sa janë*, të botuar në vëllimin tjetër, të përbashkët, që, po ashtu, përgatit Dhimitër Kamarda, *Tyletia e arbënore prej kanëkatë laoshima*, Thimi Mitko, së paku në fillimet e krijimtarisë së tij, nuk e ndien ende natyrën e versifikacionit në gjuhën shqipe. Megjithëse me strukturën metrike ritmike është më afër vargut popullor sesa, fjala vjen, vargu i Pjetër Zarishit ose, më vonë, vargu i Ndue Bytyçit, prapë vargu i tij ende nuk është varg i tonalitetit shqip:

*Këto të bëmat e tua gjith' bota do ti ketë
një nishan për Shqypërinë, e një nam t'madh për jetë
Zonzë Dorë Istriadë! Ky i bukuri jyt emër,
ndë Shqypëri do t'jesë, bres pas brezi, mun ndë zemër*⁹...

Jo vetëm inversioni i bërë ndërmjet emrit dhe peremrit në vargun e tretë, por edhe rrjedha ritmike, e rëndë, e penguar prej narracionit, dëshmojnë se këto vargje ende qëndrojnë larg vargjeve të skemës së gjatë metrike, që do të shkruhen më vonë në poezinë roman-

⁷ Qamil Haxhihasani, *Hyrje*, f. 55.

⁸ Thimi Mitko, *Vepra*, f. 706.

⁹ *A Dora d'Istria gli Albanesi*. Canti publicati per cura di D(emetrio) C(amarda). Tip. G. Falbreschi e C, livorno 1870, f. 65.

tike, kur fryma e vargut popullor të jetë bërë frymë e saj e nënkuptuar. Ndryshe prej vargjeve të skemës së gjatë metrike që do të shkruajë, fjala vjen, Naim Frashëri dhe që mund të ndahen secili në dy vargje të njëjta, këto vargje të Thimi Mitkos nuk mund të ndahen ashtu lehtë dhe nuk mund të ndahen, në radhë të parë, për shkak se artikulli i parë, respektivisht artikulli i dytë nuk janë akcentativisht prandaj as semantikisht të shquar siç janë të shquar artikujt e vargjeve të skemës së gjatë në poezinë e poetëve të mëvonshëm.

Gjatë krijimtarisë së tij të mëvonshme Thimi Mitko, pothuaj, nuk do të shkruajë më vargje të skemave të gjata metrike-ritmike. Të gjitha vjershat e tij të tjera janë të shkruara me tetërokësh, madje, me tetërokësh popullor. Në qoftë se, megjithatë edhe vargjet e dy vjershave të theksuara konsiderohen tetërokësh të dyzuar, sado pa tonalitet të tetërokshit popullor, mund të thuhet se të gjitha vjershat e tij, të botuara dhe të lëna në dorëshkrim, janë të shkruara në tetërokësh. Domethënë: ndryshe prej disa poetëve të romantizmit që fillojnë të shkruajnë në tetërokësh popullor e, mandej, ia kushton vargjeve të strukturave më të ndërlikuara, kur e kur, të krijuara edhe nën ndikimin e strukturave metrike ritmike të poezisë greke, latine, italiane ose franceze, Thimi Mitko shënon një evolucion tjetër: fillon me vargjet të skemave të gjata, pa tonalitet të shqipes, në mënyrë që më vonë, të zbulojë vargun popullor. Mbas dy vjershave të para, në të cilat ndihet fryma e vargut klasik, Thimi Mitko jo vetëm se do të kujdeset të krijojë në frymën e vargut popullor, por edhe ta imitojë plotësisht vargun popullor. Mund të thuhet, madje, se vargjet e tij janë aq dukshëm, aq fort të njëjtësuar me tetërokshin popullor sa që edhe nuk mund të quhen të emancipuar prej tij. Invencion i Thimi Mitkos është invencion plotësisht folklorik. Me strukturën figurative, me strukturën ritmike me akcentuacionin, me melodizmin, me energjinë e mbledhur, kryesisht, në fjalën e pozitës së rimës, në përgjithësi me thjeshtësinë, vargu i tij është varg, pothuaj, popullor që i dedikohet këngëtimit. Ndjenjat dhe mendimet e tij, praktikisht, jepen grosso modo, pa nuanca, herët më të shpeshta ashtu sikundër jepen edhe në poezinë popullore. Madje, edhe mallkimi, në poezinë e Thimi Mitkos, ka strukturën ritmike e figurative dhe patosin e poezisë popullore. Kështu, fjala vjen, në vjershën *Mbë shqypëtarët*, të shkruar në Kairo në vitin 1880, ai do ta mallkojë kështu individin që mohon vendin dhe vëllanë e vet:

*e marrtë nëma e nëmës,
iu nxiftë jeta e dita,
e zëntë sisa e s'ëmës
e vraftë buka e krypa!*¹⁰

Të shkruara rreth temave dhe ideve më të shpeshta të gazetarisë shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XIX, të përshkruara

¹⁰ Thimi Mitko, *Vepra*, f. 599.

prej patosit politik të kohës, të reduktuara në invencionin figurativ dhe ritmik të tetërrokshit më të shpeshtë popullor, vjershat e Thimi Mitkos janë sot më të vjetruara, më anakronike sesa vjershat e ndonjërit prej autorëve të tjerë të romantizmit shqiptar.

Thesari shpirtëror popullor

Shkrimi i vargjeve është vetëm një aktivitet i dorës së dytë, me të cilin Thimi Mitko e shoqëron aktivitetin kryesor të jetës së tij: mbledhjen e letërsisë popullore.

Me mbledhjen e letërsisë popullore shqiptarët janë marrë edhe përpara Thimi Mitkos. Madje, edhe në radhët e romantikëve janë disa krijues që, përpara tij, kanë mbledhur thesarin artistik gjuhësor të popullit dhe, në mënyrë të veçantë, poezinë popullore. Interesimi i Jeronim de Radës, ndër Arbëreshët e Italisë dhe i Zef Jubanit, ndër shqiptarët e Atdheut për letërsinë popullore, është po aq i vetëdijshëm dhe, pothuaj, po aq sistematik sa edhe interesimi i Thimi Mitkos. Mendimet që për vlerën e letërsisë popullore kanë shfaqur Jeronim de Rada, Vinçenc Dorsa, Dora d'Istria, Dhimitër Kamarda dhe, madje, Zef Jubani dëshmojnë se, edhe përpara Thimi Mitkos, shqiptarët ishin njëkohësisht të vetëdijshëm për vlerën e lartë artistike dhe për rëndësinë historike të letërsisë popullore.

Përmbledhja e Thimi Mitkos, *Bëleta shqypëtare*, e botuar në Aleksandri, në vitin 1878, megjithatë, është përmbledhja e parë e letërsisë popullore shqipe, që do të sjellë lëndën më të vlershme, në të cilën do të mbështeten mendimet mbi vlerën e lartë artistike dhe mbi rëndësinë historike dhe kulturore të thesarit shpirtëror të popullit shqiptar.

Këngët dhe krijimet e tjera të rralla popullore, që deri atëherë ishin botuar nëpër gazeta a revista, qoftë në gjuhën shqipe, respektivisht arbëreshe, qoftë në gjuhë të huaja, kryesisht, në frëngjishte, në gjermanishte dhe në italishte, nuk mund të quhen këngët dhe krijimet e tjera më reprezentative të letërsisë popullore; përmbledhja e Jeronim de Radës, *Rapsodi të një poeme shqipe*, si përmbledhje e këngëve popullore arbëreshe dhe përmbledhja e Zef Jubanit, *Përmbledhje këngësh popullore dhe rapsodi poemash shqiptare* — si përmbledhje e këngëve popullore të mbledhura në Veri, nuk mund të reprezentojnë letërsinë popullore të të gjitha viseve, ku ajo është krijuar gjatë shekujsh. Studimi i Elena Gjikes, ndërkaq, *Kombësia shqiptare simbas këngëve popullore*, përmban vlerësimet të larta dhe përgjithësime shkencore e publicistike për një krijimtari letrare artistike që nuk është si duhet e njohur ose që, shumë shumë, është vetëm me një pjesë të saj të vogël e njohur. Sado që as në të nuk botohen të gjitha gjinitë, zhanret dhe llojet e letërsisë popullore, përmbledhja e Thimi Mitkos, *Bëleta shqypëtare*, prapëprapë, është përmbledhja më reprezentative e letërsisë popullore shqipe, si në pikëpamje të kohës dhe të hapësirës në të cilën është

krijuar, ashtu edhe në pikëpamje të vlerës me të cilën është krijuar kjo letërsi. Për më tepër, mund të thuhet se kjo përmbledhje do të jetë gjatë, madje, edhe në shekullin tonë, njëra prej përmbledhjeve më të bukura të letërsisë popullore shqipe, gati një si antologji e kësaj letërsie.

Gjatë kohës sa do të jetojë në Atdhe, Thimi Mitko nuk do ta njohë si duhet dhe sa duhet letërsinë popullore, prandaj edhe nuk do të jetë i vetëdijshëm për rëndësinë e saj artistike, kulturore dhe historike. Për rëndësinë artistike, kulturore dhe historike, prandaj edhe kombëtare të kësaj letërsie ai do të bëhet i vetëdijshëm më vonë, kryesisht, gjatë udhëtimeve të tij tregtare nëpër Ballkan dhe nëpër Evropë e, sidomos, mbas vendosjes në Egjipt. Në Vjenë ku do ta sjellë puna tregtare më shpesh, ai do të njohë interesimet e qarqeve intelektuale evropiane për folklorin në përgjithësi, kurse për folklorin e popujve të Ballkanit, në veçanti. Aty, sigurisht, ai do të dëgjojë edhe për frymëzuesin e kërshërisë folklorike romantike, Herderin, të cilin edhe do ta citojë në parathënien e përmbledhjes së tij, *Bëleta shqipëtare*, që do të botojë më vonë.

Kërshërinë e tij të zgjuar për letërsinë popullore, Thimi Mitko do të mbërrijë ta plotësojë mbasi të vendoset në Egjipt. Në qytetet e Egjiptit, si në Kairo, Aleksandri, Shubin-el-Kom, Beni Suef, Mansura, Magaga, Bibe, Hajat, Minet-el-Gam, Rodhë, Mamflutë, Fishnjë e të tjera, gjatë shekullit XIX, ishin mbledhur mjaft shqiptarë që, kryesisht, merreshin me tregtinë e pambukut.¹¹ Si edhe shqiptarët e kolonive të tjera, në botën e huaj, ashtu edhe shqiptarët e Egjiptit, do të kujdesen, sadokudo, të bëjnë një jetë të përbashkët shoqësore para së gjithash, kulturore. Sikundër shkruan njëri prej këtyre mërgimtarëve të Egjiptit, Spiro Dine, që, më vonë, edhe vetë do t'i kushtohet mbledhjes së letërsisë popullore, „atë kohë, ndodheshin dhe Shqipëtarë shumë n'Egjiptë, nga do të shkonje do të piqnje Shqipëtarë. Karakollet e Kairos qenë plot Gegë e Toskë. Këngët e vallet nukë reshtnin; buzuku, tamburaja e bakllamaja buçisnin me të katër anët, na dukej sikur gjendeshim në Shqipëri”.¹² Në kushtet e tilla të jetës larg atdheut dhe, në rastet më të shpeshta, edhe larg familjeve të tyre, këta mërgimtarë përpiqen të qetësojnë mallin për vendin dhe të vetët jo vetëm me valle e me këngë, por edhe me kallëzim e me lojë: me përralla, me anegdota, me kashelasha, me gjëgjëza, me fjalë të urta, e të tjera. Krijimtaria shpirtërore bëhet, ashtu, formë e lidhjes emocionale me Atdheun.

I gjetur në mesin e shqiptarëve që me vete kishin sjellë jo vetëm vullnetin punues por edhe memorien historike dhe krijuese të popullit të tyre, në njërën anë dhe i vetëdijshëm për rëndësinë artistike, historike dhe, madje, politike të kësaj memorie në anën tjetër, Thimi Mitko i vihet, pikërisht në Egjipt, mbledhjes së thesarit gjuhësor artistik të popullit shqiptar. Përkushtimi me të cilin do ta

¹¹ Qemal Haxhihasani, *Thimi Mitko*, f. 11.

¹² Spiro Risto Dine, *Valët e detit*, Mbrothësia, Sofje 1908, f. II.

mbledhë Thimi Mitko letërsinë popullore në atë kohë, do të shquajë vetëm edhe Konstandin Kristoforidhin në mbledhjen e leksikut dhe të frazeologjisë popullore. Dëshimtari i jetës kulturore të shqiptarëve në Egjipt, Spiro Dine, do ta dëshmojë fare bukur edhe përkushtimin prej folkloristi të Thimi Mitkos: „Kur e poqa herën e parë në Han Alil ku kish shkresëtoresh, më priti si një mëmëdhetar i vërtetë edhe e para fjalë që më pyeti më tha në di ndo një këngë e përrallë të vjetërë. Po mua kjo m'u duk si çudi dhe vura buzën më të qeshur, po më së fundi ma bushi mëndjen duke thënë për Kamardën, prift Ahi mandrit filolog i math shqipëtar nga Idvorna e Italisë, dhe Panajoti Kupitori nga Idhra e Greqisë, edhe shumë e shumë të tjerë filologë të mbledhjen evropiane, të cilët thonë: që në këngët dhe në përrallat e vjetëra të një populli, ruhen zakonet, gjuha dhe Historia e vet”.¹³

Mbas disa vjetësh të mbledhjes, ashtu, të përkushtuar të letërsisë popullore, Thimi Mitko, në vitin 1874, e bën gati për shtyp përmbledhjen së cilës i vë titullin *Bëleta shqypëtare* duke simbolizuar me të edhe përkushtimin e tij të gjatë ndaj letërsisë popullore,¹⁴ edhe përkushtimin e popullit ndaj gjuhës së vet. Përmbledhjen e tij, Thimi Mitko do të mbërrijë ta botojë vetëm katër vjet më vonë, në vitin 1878. Mbas botimit të kësaj përmbledhjeje ai do të vazhdojë ta mbledhë edhe më tutje letërsinë popullore. Njëkohësisht, të njohurve dhe bashkëpunëtorëve të tij, sikundër janë Jeronim de Rada, Dhimitër Kamarda, Dora d'Istria, Gustav Majer, Jan Urban Jarnik, e të tjerë do të vazhdojë t'u dërgojë material folklorik, që ata do të kujdesen edhe ta botojnë nëpër gazeta a revista në gjuhë shqipe ose në gjuhë të huaja. Brenda disa vjetësh ai do të mbërrijë të bëjë gati edhe një përmbledhje tjetër, që do ta titullojë *Bëleta e vogëlë* dhe do ta titullojë, kështu, jo vetëm pse vëllimisht mund të ishte më e vogël se *Bëleta shqypëtare*, por edhe pse do bëhej gati mbas saj.

Zhanret, koha dhe hapësira

Sikundër mund të shihet prej përmbledhjes së botuar, *Bëleta shqypëtare*, prej përmbledhjes së pabotuar, *Bëleta e vogëlë* dhe prej krijimeve popullore që për të gjallë boton nëpër gazeta a revista në gjuhën shqipe ose edhe në gjuhë të huaja, Thimi Mitko është kujdesur të mbledhë krijime popullore të gjinive, të zhanreve dhe të llojeve të ndryshme. Kështu, fjala vjen, mund të vërehet se ka mbledhur: këngë të vegjël, këngë komike, këngë që këndohen në muajin maj, këngë që këndohen kur do të bjerë shi, këngë që këndohen kur dalin dhembët për të dytën herë, këngë që këndojnë çupat ditën e parë të marsit, këngë që i kushtohen hënës së re, këngë për lulet e zogjtë, këngë të motmotit, këngë për festat, këngë që kë-

¹³ *Aty*, f. I—II.

¹⁴ Qemal Haxhihasani, *Thimi Mitko*, f. 74.

ndohen kundër gjarpërinjve dhe kafshëve të tjera të dëmshme, këngë dashurie me llojet e këngëve të dasmës, të këngëve të nizamit, të këngëve të kurbetit, vaje dhe këngë të përvajshme, këngë epike, balada, këngë historike, mandej përralla, fabula, anekdota, fjalë të mençme, gjëegjëza ose, si i quan vetë Thimi Mitko, fjalë të errëta të përshëndoshura, emra karakteristikë muhamedanë dhe të krishterë, mbiemra karakteristikë familjesh, e të tjera.

Prej këtyre gjinive dhe zhanreve mund të shihet se Thimi Mitko është kujdesur që të mbledhë krijime popullore të zhanreve të ndryshme, por edhe të periudhave të ndryshme kohore.

Prej krijimeve popullore që ka botuar dhe prej krijimeve popullore që ka lënë në dorëshkrim, mund të shihet se Thimi Mitko, njëkohësisht, është kujdesur që të mbledhë letërsi popullore prej viseve të ndryshme: prej Atdheut dhe prej kolonive shqiptare të botës së huaj. Kështu, për shembull, mund të vërehet se në përmbledhjet e tij mund të gjenden krijime popullore, që këndohen, tregohen ose thuhën në Jug, në Veri, ndër Arbëreshët e Italisë dhe ndër Arbëreshët e Greqisë: krijime popullore prej Malësisë së Shkodrës e Përmetit, Skraparit, Myzeqesë, Kosovës, e prej Krahinave të tjera. Jo vetëm krijimet që ka mbledhur ai në përgjithësi, por edhe vetëm përmbledhja *Bëleta shqypëtare* bëhet, ashtu një si parlament i folklorit gjuhësor shqiptar që përfaqëson të gjitha viset ku është krijuar ai. Domethënë: sidomos, përmbledhja e parë, *Bëleta shqypëtare*, sa i përket prejardhjes krahinore të krijimeve të përmbledhura në të, ka karakter panshqiptar. Në kuadrin e krijimeve popullore që mbërrin të mbledhë dhe të publikojë deri në vitin 1878, Thimi Mitko nuk mbërrin të mbledhë dhe të prezentojë sa mendon se duhet edhe letërsinë popullore në të folmen e Arbëreshëve të Italisë. Këtë mungesë në përmbledhjen e tij të parë Thimi Mitko do të kujdeset ta plotësojë me përmbledhjen e dytë, *Bëleta e vogëlë*. Nuk është e çuditshme, prandaj, pse në letrën që i dërgon, në vitin 1880, i thotë Jeronim de Radës se në vëllimin e dytë, në *Bëletën e vogëlë*: „do këllas edhe tre a katërë kënka nga Rapsodia e tua Skënderbeku i pafan”.¹⁵ A thua Thimi Mitko, vërtet, mendon se rapsoditë e poemës së Jeronim de Radës, *Skanderbeku i pafan* nuk janë krijime origjinale po këngë popullore? Jo, pa dyshim. Pse, atëherë, do të donte të fusë në përmbledhjen e tij edhe këngë të kësaj poeme? Sepse, ai do të donte të fuste në përmbledhjen e tij të ardhshme, *Bëleta e vogëlë*, edhe me shumë krijime popullore të periudhave dhe të trevave që nuk ishin mjaft të prezentuara në *Bëletën shqypëtare*. Kohës kur janë krijuar dhe, sidomos, hapësirës ku janë krijuar njësitë folklorike që mbledh Thimi Mitko u kushton rëndësi, në radhë të parë, për arsye se me thesarin e mbledhur shpirtëror të popullit dëshiron të dëshmojë traditat e pasura kulturore të shqiptarëve dhe, njëkohësisht, të ndikojë në realizimin e një qëllimi praktik aktual: në afrimin e shqiptarëve pa dallim feje. „Duke harxhuar

¹⁵ Thimi Mitko, *Vepra*, f. 642.

për këtë mbledhje — shkruan ai në fletëlaajmërimin e *Bëletës shqypëtare* — me shumë vitëra vazhdimërisht, mundime dhe të prishura jo të pakëta, e numërojnë këtë si të shkruarën më të përshtatshme e të mirë për zgjuarjen dhe bashkimin e shqiptarvet përgjithësisht. Sepse lënda e kësaj mbledhjeje, dukmeqenë krijesë e bashkësishme shqiptarësh të krishterë e myslimanë, pa fanatizmin besimtar me të vogël, po më tepër me besëlinë më të madhe, e cila është karakteristika kryesore e shqiptarve, ka për të qenë këndimi më i kënaqshëm, si i të krishterit edhe i muhamedanit dhe në këtë mënyrë do të njohë historinë e tija, rrënjën të tija edhe bashkëgjakërinë të të gjithë Shqipërisë¹⁶. Ai është i bindur, gjithashtu, se krahas funksionit artistik dhe patriotik, letërsia popullora që po mblidhte dhe po botonte, do të kryejë edhe një funksion tjetër të rëndësishëm në atë kohë: do të mund të shfrytëzohet si lëndë e studimeve shkencore në disa fusha. Ai e mblodh thesarin shpirtësor popullor jo vetëm që „t'u bëhet mësim i përbashkët gjithë shqiptarve pa ndryshim mendimi politik ose feje”, por që t'u bëhet „edhe filologëve që studiojnë, një shkak për studime edhe mendime të tjera etnologjike më të mbaruara”.¹⁷ Pavarësisht pse mundësitë e tij studiuese janë modeste, Thimi Mitko do të kujdeset që ta realizojë edhe vetë porosinë që u jep filologëve.

Fillimet e folkloristikës shqiptare

Prej parathënies prej Fjalorit shqip-greqisht dhe prej shpjegimeve, kryesisht, historike a etnografike që u bënë disa njësive në përmbledhejn *Bëleta shqypëtare* shihet qartë se, përpos me mblidhjen, Thimi Mitko do të merret sado pak edhe me studimin e letërsisë popullore. Shënime me të cilat i përcjell ai disa prej krijimeve, posaçërisht disa prej këngëve popullore të përmbledhjes *Bëleta shqypëtare* hyjnë ndër kritikën e para të folkloristikës në gjuhën shqipe. Herët më të shpeshta ato përbëhen prej të dhënash mbi vendin, kohën, ngjarjen, personazhet e, më rrallë, edhe për ndonjë komponente tjetër të krijimit popullor. Këto shënime, në përgjithësi, janë fare të shkurtra, por edhe fare të qarta dhe koncize. Të vëna në fund të tekstit përkatës, ato lënë përshtypjen e fusnotave sqaruese, që do të ishin shpesh, më të rëndësishme po të ishin më të gjata. Shënime sqaruese, kritike, me të cilat Thimi Mitko i përcjell disa prej krijimeve popullore të përmbledhjes së tij, *Bëleta shqypëtare*, kur e kur shndërrohen edhe në vlerësime ngjarjesh dhe personazhesh. Kështu, fjala vjen, një prej personazheve të këngëve historike Kara Mahmud pasha do të jetë „një burrë trim i punës dhe luftëdashës”, kurse një personazh tjetër, Rexhep Çollaku, do të jetë „burrë me një trimëri të patundur”, por edhe „lavdëdashës”. Mund të njgasë, ndërkaq, që përshtypjet e ngjarjes, të kohës dhe

¹⁶ *Aty*, f. 557—558.

¹⁷ *Aty*, f. 63.

të vendit të shndërrohen në rrëfim të shkurtër historik, respektivisht poetik mitologjik. Duke e sqaruar vrasjen e Isuf beut të Beratit prej kryengritësve të Rrapo Hekalit, Thimi Mitko do të kallëzojë edhe se: në Berat është i lindur Ptoleme Lagu — njëri prej komandantëve të shquar të Aleksandrit të Maqedonisë — i cili — siç thotë — do të bëhet sundues i Misirit ku, mandej, do të sundojnë edhe 13 nipër të tij. Do të na kallëzojë, në vazhdim, se në fushë të Beratit „duke luftuar për atdhenë kundra turqve lëvdatësisht” është vrarë princi Balça, „ndihmëtari i të përmendurit Gjergj Kastrioti”.¹⁸ Përpos sqarimeve mbi ngjarjet, personazhet, kohën dhe hapësirën në kallëzime historike a poetike mitologjike, kur e kur mund të kthehen edhe spjegimet e disa fjalëve të Fjalorit shqip-greqisht, që është vënë në fund të *Bëletës shqypëtare*. Në shpjegimet që i bën fjalës gjeraqinë, fjala vjen, do t'i mësojmë edhe fjalët: petrit, sqyfer, skli-fter, sqyfter, qift, shkabonjë, shkabë dhe shqyponjë e, mandej, do ta dëgjojmë legjendën e shënuar prej Plutarkut e, më vonë, prej Hanit, që, aq me qejf, e përsërisin romantikët tanë: kur Pirrua dëgjoji se ushtarët e tij e quajnë shqiponjë, „falë bëmave të tij të mëdha” u përgjegj „në se unë jam shqiponja, ju jeni krahët e mij”.¹⁹ Si këto sqarime, ashtu edhe Fjalori shqip-greqisht, me fjalë të huaja dhe me disa fjalë të rralla shipe, në përmbledhjen *Bëleta shqypëtare*, dëshmojnë qartë se porsi romantikët e tjerë edhe Thimi Mitko interesohet edhe për çështje të gjuhës. Po, më parë se prej aspektesh thjesht linguistike, çështjet gjuhësore ai i shikon prej aspektit kombëtar, politik dhe kulturor.

Gjuha në teori dhe në praktikë

Megjithëse nuk mund të quhet njohës i mirë i gjuhës shqipe, sidomos jo në prozën dhe në letërkëmbimet. Thimi Mitko ka pikëpamje të drejta për shkrimin e gjuhës dhe për ardhmërinë e saj. Edhe ai hyn në radhën e atyre romantikëve tanë që, si teorikisht, ashtu edhe praktikisht, do të përpiqen ta ndihmojnë afrimin e dy dialekteve kryesore. Ai do të kujdeset që në toskërishten e tij jugperëndimore, që është e folme e shkrimeve të tij,²⁰ të fusë edhe fjalë të dialektit të gegërishtes dhe të disa të folmeve të shqipes. Kështu, për shembull, ai do të përdorë fjalët gegërishte sikundër janë: lundër, uzdajë, sheste, orok, shegert, gërçak, thupër, jerm e të tjera; fjalë të arbërishtës, sikundër janë: shërbesë, lëpushë, zbjerë, i vapëkët për i varfër, adha, e të tjera; trajta të hershme fonetike, të përdorura në shkrimet e autorëve të vjetër, sikundër janë: klaj, klishë, gluhë, e të tjera të ngjashme.²¹

¹⁸ *Aty*, f. 301.

¹⁹ *Aty*, f. 492.

²⁰ Qemal Haxhihasani, *Hyrje*, f. 52.

²¹ *Aty*, f. 52.

Krahas përpjekjeve për afrimin e dialekteve, Thimi Mitko do të bëjë përpjekje edhe për pastrimin e shqipes prej fjalëve të huaja. Duke i shënuar besnikërisht pjesën më të madhe të krijimeve popullore, ai do t'i shënojë edhe me fjalët e huaja që në to përdoren, por për shkak të tyre, në fund të pëmbledhjes *Bëleta shqypëtare* ai edhe e vë Fjalorin shqip-greqisht, në të cilin, përpos fjalëve të rralla të shqipes, i shënon edhe ato fjalë të huaja, që ia merr mendja se nuk duhet të përdoren më në shqipen. Fjalët e huaja në gjuhën shqipe për të janë „tërësisht të tepërta, të pavlefshme dhe kakofone”. Për këtë arsye është i mendimit se fjalët „me origjinë dhe rrënjë të huaj duhet t'i flakë populli shqiptar, sepse, përveç se janë plotësisht të tepërta e kakofone, prishin gjuhën”.²² Megjithëse jo me suksesin e romantikëve të mëvonshëm të Konstandin Kristoforidhit, të Naim Frashërit, të Sami Frashërit e, pjesërisht, as, të Jani Vretos — ai do të kujdeset që pikëpamjet mbi pastërtinë e gjuhës t'i zbatojë edhe në praktikën e tij gjuhësore. Një sërë fjalësh të huaja, para së gjithash, orientalizma dhe greqizma, si do t'i zëvendësojë me fjalë të shqipes: me fjalë të shqipes, që do t'i marrë ose prej popullit, ose prej romantikëve të tjerë ose, madje, edhe me fjalë që do të krijojë vetë. Kështu, për shembull, fjalën gazetë do ta zëvendësojë me fjalën ditëtorë; patriot me ventar; patriotizëm me ventari; shekull me qindore; i abonuar me ndihmëtar; artikull gazete me nyl; duhan me tymës; gjerdan me gushore, rrethgushe; berber me qethës; dava me paditjeje, qarëje; gajret me zell, sillë, ndezë; furrëxhi me bukëtar; penxhere me dritësore, realizohet me punësohet; legjitim me i drejtëhakshëm; karauil me luar, vështor, shëkues, ruejtës;²³ çohadarë me krerë; bejlerë me bujerë; hamam me lanjëtur; kadi me gjyqtar; asqer me ushtar, e të tjera.²⁴ Poaq bukur, ndoshta, sa disa prej këtyre fjalëve, që krijon vetë ose huazon prej shkrimtarëve të tjerë, tingëllojnë fjalët ose togfjalëshit që krijon për emërtimin e nocioneve gjeografike. Kështu, fjala vjen, tingëllojnë bukur — sado nuk kanë mbetur në përdorim — togfjalëshat gjeografikë Evropa Lindiellore për Evropën e Lindjes, Lindiella ose Deldiella për Lindjen, e të tjera. Është konstatuar se Thimi Mitko do ta ndihmojë zhvillimin e shqipes dhe pastrimin e saj prej fjalëve të huaja edhe me përdorimin e fjalëve të rralla siç ishin atëherë: shtresë, shkorsë, plis, stringë, udhëtar, bukëdhënë, sulm, verore, shpërenj, lazhdëronj, shugatem, befas, së qetëthi, të tjera; me përdorimin në funksione e me kuptime të reja, të fjalëve siç ishin: dijë, dije, vërvitje, dëshmoj, de-tyrë, ndërtesë, dhëmbje, dëruaj (rekomandoj) e të tjera; me formimin e fjalëve të reja siç janë: vetëdije, vetënjohje, padije, paditje, dëshmi, dëshmitar, dhjetar, vendëri (atdhe), pemëtar (i frytshëm), të keqe, të dhemburë, të vojturë, follëtonj, parëflas, e të tjera.²⁵

²² Thimi Mitko, *Vepra*, f. 479.

²³ Qemal Haxhihasani, *Hyrje*, f. 52—53.

²⁴ Qemal Haxhihasani, *Thimi Mitko*, f. 68.

²⁵ Qemal Haxhihasani, *Hyrje*, f. 53.

Në qoftë se në kohën kur e mbledh lëndën e përmbledhjes së parë, *Bëleta shqypëtare*, qëndrimet e tij gjuhësore ende mund të quhen liberaliste, në kohën kur e mbledh lëndën për përmbledhjen e dytë, *Bëleta e vogëlë*, liberalizmi i tij gjuhësor do të shndërrohet në një purizëm të vërtetë. Është vërejtur se në këtë kohë — e është koha mbas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit — prej përrallave dhe prej anekdotave që mendonte të fuste në këtë përmbledhje, do të përjashtojë jo vetëm të gjitha fjalët e huaja, madje, edhe një varg të atyre që mund të quhen të përvetësuarat prej shqipes, por edhe do të provojë të shqiptarizojë emra personazhesh, që mund të shqiptarizohen. Gjurgjylë çingjija e përrallave do të quhet prej tij Vallëtoresa fustanalle.²⁶

Përdorimi i fjalëve të reja të krijuara prej romantikëve të tjerë dhe krijimi i fjalëve të reja të krijuara prej tij në shkrimet e Thimi Mitkos, ndonjëherë, është më tepër një ekspresion kombëtar sesa një akt gjuhësor kulturor i vërtetë. Mund të thuhet kështu jo vetëm për shkak se shpesh e tregon një invencion të kufizuar qoftë në pikëpamje të krijimit, qoftë në pikëpamje të përdorimit të fjalëve të reja, por edhe për shkak se më tepër se cilësisë i kontribuon sasisë së leksikut të shqipes. Njëkohësisht në praktiken gjuhësore ai përdor edhe fjalë të huaja, kryesisht, greqizma që në asnjë rast nuk do t'i përdornin romantikët e tjerë, me vetëdije të fortë gjuhësore, ose krijon fjalë që s'u ngjajnë fjalëve shqip. Kulturën gjuhësore të Thimi Mitkos, gjithsesi, e cënojnë fjalët sikundër janë tiparit a metatiposje a shtyposnje për botim; mbarëprapëta për tërheqje; pameta për përsëri; metapamje për revistë; kosmet për botë; patridhë për atdhe; sillog për shoqëri; qytyk për regjistër; haromë për para; heros për ngakoj; parthine për para pak kohe; mbarazi për apostafat; anticili për smirë; harpudhos për studioj, e të tjera të ngjashme.

Më tepër se me lokalizmat, më tepër se me greqizmat dhe më tepër se me neologjizmat, që nuk tingëllojnë shqip, prandaj edhe nuk kanë mbetur në gjuhën shqipe, Thimi Mitko dëshmon se nuk e njeh mirë shqipen me sintaksën e fjalisë së tij. E krahasuar me fjalinë e Konstandin Kristoforidhit, të Naim Frashërit dhe të Sami Frashërit të shpesh të herëve ajo është fjali pa aksentin dhe tonalitetin e shqipes. Fjalët e huaja dhe neologjizmat që nuk tingëllojnë shqip bëhen elemente plotësuese, që i vështirësojnë pranimin estetik të fjalisë së tij.

Bëleta shqypëtare dhe konteksti letrar evropian

Po, në historinë e letërsisë romantike Thimi Mitko nuk hyn për shkak të meritave gjuhësore; e sado aktiviteti i tij prej folkloristi ka rëndësi të veçantë edhe gjuhësore, në historinë e letërsisë romantike Thimi Mitko hyn për shkak të meritave si mbledhës i le-

²⁶ *Aty*, f. 52.

tërsisë popullore dhe për shkak të ndikimit se përmbledhja dhe, në përgjithësi, krijimtaria popullore që mbledh ai, ushtron në letërsinë shqipe deri në fund të shekullit XIX. Interesimin e zgjuar të inteligjencës shqiptare të Rilindjes Kombëtare për traditat kulturore dhe, në mënyrë të veçantë, për letërsinë popullore më plotësisht do ta zgjojë vetëm Thimi Mitko me përmbledhjen e tij, *Bëleta shqypëtare*. Rëndësinë e kësaj përmbledhjeje nuk mund ta pakësojë, ndërkaq, interesimi joadekuat me të cilin kjo përmbledhje do të pritët jashtë kontekstit letrar dhe kulturor shqiptar. Me gjithë lëndën e pasur, të gjinive, të zhanreve dhe të llojeve të ndryshme, përmbledhja e Thimi Mitkos, *Bëleta shqypëtare*, nuk do të zgjojë në Evropë, interesimin që meritonte dhe që do të kishte zgjuar, në gjysmën e parë të shekullit po të ishte botuar ashtu e mbledhur dhe ashtu e zgjedhur, siç po botohej e mbledhur dhe e zgjedhur më 1878.

Pse mund të thuhet kështu?

Në kohën kur botohet përmbledhja e Thimi Mitkos, Evropa e gjysmës së dytë nuk është më Evropa e gjysmës së parë të shekullit. Nën ndikimin e ndryshimeve të mëdha që e kishin pushtuar duke filluar prej Revolucionit të madh frances, kishte ndryshuar shumë harta politike e Evropës. Ishin rrënuar fuqi dhe lidhje të vjetra dhe ishin krijuar fuqi dhe lidhje të reja. E fuqitë dhe lidhjet e reja kishin vënë në rend të ditës aspirata dhe programe të reja politike dhe ekonomike. Në këtë kohë do të bëhet rindarja e sferave të interesit ndërmjet fuqive të mëdha, do të caktohen dhe do të ricaktohen kufijtë e kombeve të vogla; do të kolonizohen hapësira të reja edhe në kontinente të tjera. Ngjarjet që sjellin Kongresin e Berlinit, gjithsesi, do të shuajnë kërshëri të vjetra dhe do të sjellin kërshëri të reja. Nën ndikimin e ndryshimeve të mëdha që bëhen, ashtu në jetën e popujve është e kuptueshme të ndryshojnë edhe interesimet dhe shijet shkencore, artistike dhe kulturore. Interesimi i njohur romantik për popujt e panjohur ose më pak të njohur dhe për traditat e tyre në gjysmën e dytë të shekullit pothuaj, ishte kapërcyer. Në vend të ekzotikës dhe të idealizmit romantik, invencionin krijues tani e pushtojnë realizmi, natyralizmi dhe pozitivizmi. Nuk ka dyshim se me strukturën e tillë artistike, shkencore, kulturore dhe politike konteksti intelektual i kësaj kohe nuk i përgjigjej përmbledhjes së Thimi Mitkos, *Bëleta shqypëtare*.

Thimi Mitko, ndërkaq, nuk iu kishte përkushtuar mbledhjes së thesarit popullor shqiptar për të zgjuar interesimet artistike, shkencore a kulturore të Evropës; Thimi Mitko iu kishte kushtuar mbledhjes dhe publikimit të thesarit shpirtëror të popullit, në radhë të parë, për arsye të tjera: për ta shpëtuar atë prej harresës për të zgjuar kërkesat kulturore kombëtare për të ndihmuar studimin e traditave kulturore dhe, në përgjithësi, të historisë kombëtare. Dhe qëlimeve të tilla *Bëleta shqypëtare* do t'u shërbejë edhe më tepër, edhe më mirë se ç'kishte mundur të parashihte autori i saj. Lënda folklorike që mbledh Thimi Mitko dhe, në mënyrë të veçantë, lë-

nda folklorike e botuar në *Bëletën shqypëtare*, do të jetë burim i nxitjeve krijuese në romantizmin shqiptar më tepër se asnjë vepër tjetër e letërsisë shqipe deri në atë kohë.

Në qoftë se në letërsinë e romantizmit shqiptar është një rrjedhë e fortë e krijimtarisë poetike që mbështetet në letërsinë popullore, atëherë është e sigurtë se zgjerimit, thellimit dhe pasurimit të kësaj rrjedhe, më së shumti i kontribuon Thimi Mitko me përmbledhjen e tij, *Bëleta shqypëtare*. Ndikimit të saj, njëkohësisht, i detyrohet shumë depërtimi i leksikut folklorik në letërsinë e etapës së dytë të romantizmit tonë. Për me tepër, me ngarkesën e madhe semantike dhe simbolike ajo do t'i shërbejë më dukshëm dhe më gjithanshëm se asnjë vepër tjetër e kohës programit kombëtar historik, gjuhësor, letrar dhe, më në fund, politik të Rilindjes kombëtare.

Dhe, pse të mos i shërbejë?

Me ngarkesën e madhe semantike dhe simbolike, që mbështetëj në krijimet e saj të zhanreve, të periudhave dhe të viseve të ndryshme të shqipes, ajo ishte monument deri atëherë më i rëndësishëm i kulturës shpirtërore të popullit shqiptarë, *topographia sacra* e historisë dhe e traditës së tij.

Rexhep Qosja

SÉMIOTIQUE DES MONUMENTS

Résumé

Thimi Mitko est un nom célèbre du romantisme albanais. En dehors de *L'Abeille albanaise / Bëleta Shqipëtare* où il a recueilli le trésor spirituel du peuple albanais, il écrivit un grand nombre d'essais et d'articles traitant des questions de son époque ayant un caractère historique, politique, ethnographique, anthropogéographique et historico-artistique, en étant à l'origine d'un genre particulier de la prose publiciste du mouvement romantique albanais: la prose historique littéraire. La prose historique littéraire de Thimi Mitko par la description des monuments culturels et l'analyse de certains mots mit en lumière leur signification et leur symbolisme et apporta la meilleure réponse objective aux divers écrits contestant l'existence de la langue albanaise, la culture et l'histoire du peuple albanais. En plus de ses proses Thimi Mitko écrivit un petit nombre de poèmes. Ces poèmes n'ont pas de valeur artistique. Ces écrits concernant des thèmes et des idées le plus souvent inspirés par le journalisme albanais de la deuxième moitié du XIX^e siècle et empreints de la couleur politique de l'époque sont aujourd'hui des poèmes qui ont davantage vieilli que ceux des autres auteurs romantiques albanais.

Cependant Thimi Mitko acquit une place de choix dans la littérature romantique albanaise avec *L'Abeille albanaise / Bëledën Shqipëtare, Bële-*

ta *Shqyptare*, imprimées à Alexandrie en 1878. C'est le premier recueil de littérature populaire albanaise qui renferme des écrits très précieux qui permettront d'apprécier la grande valeur artistique et l'importance historique et culturelle du trésor spirituel du peuple albanais. Comme on peut le voir d'après ce recueil comme aussi d'après le volume non imprimé *La petite Abeille / Bëleta e vogëlë*, Thimi Mitko s'est appliqué à rassembler les créations populaires de genres et de catégories diverses tels: les chants des petits enfants, les chants comiques, les chants du mois de mai, les chants interprétés lorsqu'il pleut, les chants qu'on chante lorsque les dents poussent pour la deuxième fois, les chants que chantent les filles le premier mars, les chants dédiés à la nouvelle lune, aux fleurs, aux oiseaux, les chants du cycle de l'année, les chants de fête, les chants qu'on exécute pour éloigner les serpents et les autres animaux nuisibles, les chants d'amour et de mariage, les chants du Nizam / soldat, les chants d'exil, les lamentations et les chants funèbres, les chants épiques, les ballades, les chants historiques, puis viennent ensuite les contes, les fables, les anecdotes, les proverbes, les devinettes ou bien comme les désigne Mitko les mots énigmatiques, les salutations, les noms caractéristiques islamiques et chrétiens, les noms de famille et autre. A partir des oeuvres populaires qu'il a imprimées et des écrits populaires qu'il a réunis en manuscrits on peut voir que Thimi Mitko a glané la littérature populaire dans des régions différentes: dans sa patrie et dans les autres colonies albanaises à l'étranger. De même que les autres romantiques albanais Thimi Mitko s'est aussi intéressé à la question de la langue. Cependant il considère davantage les questions de la langue sous l'aspect national, politique et culturel que proprement linguistique.